

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE "LC-LINK" sh.p.k.**

KAPITULLI 1

Dispozita te Pergjithshme

- Silvi Shehi, atësia Luan, amësia Mimoza, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Zonja. Curre; Nd. 28/1; Njësia Administrative Nr. 2; Njesia Bashkiake Nr. 2; 0000; Tiranë, lindur më 01/06/1994, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Leternjoftim ID nr. 037229114 dhe nr. personal J40601071B.
- Elis Sulaj, atësia Agim, amësia Flora, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Xhoxhi Martini; Nd. 28; H. 1; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1001; Tiranë, lindur më 31/08/1986. gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Leternjoftim ID nr. 036449187 dhe nr. personal I60831064O.

Ortakët me lart janë madhor me zotësi të plote juridike dhe për të vepruar, të cilët mbështetur në ligjin Nr.9901, dt.14/04/2008, "Për Shoqëritë Tregtare" I ndryshuar, dhe në legjislacionin shqiptar në përgjithësi, vendosen si më poshtë vijon:

Emertimi, Selia dhe afati i Shoqërisë

Neni 1

Të themelojë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar, për të zhvilluar veprimtari tregtare. Shoqëria është person juridik shqiptar, veprimtaria e të cilit rregullohet nga akt themelimi, statuti i saj dhe legjislacioni në fuqi.

Neni 2

Shoqëria do të emërtohet "**LC-LINK**" sh.p.k.

Neni 3

Shoqëria do të ketë Selinë e saj në Tiranë, Rruga Xhavit Shyqyri Demneri, ndertesa nr.35.

Selia e shoqërisë mund të transferohet.

Neni 4

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj me afat të pakufizuar. Afati mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 5

Aktiviteti i shoqërisë

Shoqëria "**LC-LINK**" sh.p.k. do të ketë si objekt:

- Ushtrimin e aktivitetit vetëm për ndërtim objektivësh shumë katëshe, rezidenciale, rrugësh, rikonstruksione, punime hidraulike, elektrike, punime gipsi, suvatime, sisteme ngrohje-ftohje etj;
- Ushtrimin e aktivitetit shitje-blerje, objekte industriale, materiale elektrike dhe hidraulike, social-kulturorë, bujqësorë, turistike, hoteleri, ujesjellesa, punime restaurime dhe rikonstruksioni, punime të dheut, murature, punime betoni, punime të shembjes, kompletimin me instalime të brendshme të objekteve të ndërtuara, marrjen dhe dhenien me qira të pajisjeve të ndërtimit, të mjeteve të

transportit per ndertim dhe tregetim te tyre. Furnizim, vendosje, sherbime, furnizim-montim panele diellore.

- Importim, eksportim dhe tregetimin e te gjithave llojeve te materialeve, automjeteve me goma dhe zinxhire te tipeve te ndryshme te makinerive, pajisjeve dhe impianteve te ndryshme te karakterit public, industrial, bujqesor, tregetar, kulturor, sportive te sherbimeve. Ndertimi i kapanoneve industriale dhe bujqesore te te gjitha llojeve;
- Tregetim me shumice dhe pakice te artikujve te ndryshem industrial, produkteve bujqesore, ushqimore, materiale ndertimi, elektrike, hidraulike, sisteme ngrohje ftohje dhe materiale te sistemit te mbrojtjes nga zjarri, pesticidet, pajisje elektronike, konfeksione
- Grumbullimi dhe depozitimi i materialeve inerte ndertimore jo te rrezikshme.
- Ne fushen e tregetise, import-eksport te mallrave dhe pajisjeve industrial, makinerive, automjeteve e agregateve te industries Agro dhe Agro-Ushqimore.
- Punime elektrike dhe montimi te sistemeve te projektuara elektrike hidraulike, ngrohje- ftohje dhe mbrojtjes ndaj zjarrit. projektim, konsulence per ndertim e zbatim te veprave ndertimore publike dhe private, objekte turistike, ushtarake, kulti, industriale dhe te veprave ndertimore te te gjitha llojeve sipas legjislacionit shqiptar; restaurime ne pergjithesi, rikonstruksione veprash arti. Studime urbanistike te te gjitha niveleve; planifikim urban; projektim arkitektonik; projektim strukturash mbajtese beton arme, metalike; projektim rrugesht te te gjitha niveleve, ura, tunele, nenkalime, autostrada, trase hekurudhore mbi dhe nentoke, portesh, aeroportesh, heliportesh; projektim linjash dhe sistemesh se prodhimit dhe shperndarjes se energjise elektrike: Linja mbitokesore dhe nentokesore per energjine dhe telekomunikacionet, centrale; projektim ujesjelles, kanalizime, vepra ujitjeje, vepra bonifikuese e ujore, vepra kullimi, impiante vaditese, diga, dampa, etj; projektim vepra naftesjelles, gasjelles, etj; projektim fotogrametrik, hartografik, topografik; konsulenca tekniko-ekonomike sipas kategorive dhe nenkategorive te licensave profesionale dhe cdo lloj studimi dhe projektimi, qe nuk permendet me siper. Studime fizibiliteti. vleresime mjedisore, etj..
- Cdo aktivitet tjeter te nevojshem per realizimin e qellimit te Shoqerise.
- Aktivitet në fushën e ndërtimit, sigurise dhe mbrojtjes civile: Hartimi i projekteve te mbrojtjes nga zjarri, relacione teknike perkatese per te gjitha llojet e ndertimeve si dhe zbatimi i tyre. Hartimi i akteve te ekspertizes teknike per zjarret e rena. Dhenia e asistences teknike dhe trajnimi i punonjesve per sigurine. Sherbime ekspertize dhe profesionale te mbrojtjes civile. Import dhe tregitim me shumice dhe pakice te paisjeve dhe lendeve qe nevoiten per shuarjen e zjarreve dhe shpetimin. Tregitim dhe shitje me shumice dhe pakice te mallrave te ndryshme elektrike, hidraulike, elektronike, ndertimi, makineri, automjete zjarrfikese e paisje per stervitje. Mirëmbajtja dhe instalimi i sistemeve per sigurinë nga zjarri dhe shpetimin. Kolaudime, riparime, mbushje dhe sherbime te paisjeve dhe mjeteve per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin. Trajnime dhe kurse profesionale per çdo punonjes ne fushen e sigurise teknike, sigurise dhe shendetit ne pune, mbrojtjes nga zjarri, perdorimin e pajisjeve dhe mjeteve zjarrfikese. Ofrim konsulence menaxhimi dhe hartimi i dokumentit te vleresimit te riskut per çdo pozicion pune. Ofrime sherbimesh dhe keshillime per krijimin e sistemit parandalues nga rreziku i renies se zjarrit dhe planin e evakuimit. Keshilla dhe sherbime te jashtme te specializuara, sherbime shendetesore, mjeksia e punes, ergonomia, higjena industriale, aspekte psiko-sociale te punes dhe dhenia e ndihmes se pare. Tregti te mjeteve dhe veshjeve te punes dhe te veshjeve per mbrojtjen nga zjarri. Sigurimi i organizimit te vendit te punes dhe mjeteve te nevojshme mbrojtese. Informimi, keshillimi dhe trajnimi profesional i punemarresve dhe perfaqesueve te tjere, integrimi dhe dhenia e keshillimit ne perdorimin dhe futjen e teknologjive te reja, duke vene ne dukje pasojat e tyre per sigurine dhe shendetin e punemarresve. Kurse te formimit profesional ne fushat: Siguria dhe shendeti ne pune. Mbrojtja nga zjarri.
- Cdo lloj materiali me shumice dhe pakice dhe cdo lloj sherbimi qe lejohet nga legjislacioni ne fuqi.
- Cdo aktivitet tjeter te nevojshem per realizimin e qellimit te Shoqerise.

Neni 6

Kur shoqeria pushon veprimtarine e saj, pasi shlyen te gjitha detyrimet qe ka, pjesen e mbetur te kapitalit dhe te te ardhurave e perfitojne ortakët e saj.

Ortaku themelues perballon humbjet e shoqerise deri ne kufirin e vleres se saj te derdhur ne formimin e kapitalit themeltar. Kapitali baze mund te rritet nga fitimi ne natyre, ose kredi ne leke ose valute qe merret ne Bankat e Shtetit Shqiptar.

Kapitali themeltar per vazhdimin e aktivitetit te shoqerise është në 100 Leke, qe i takon ortakeve themelues si me poshte:

1. Ortaku **z. Silvi Shehi** : Zoterues i 1 (nje) kuote me vlerë të përgjithshme 50 Leke që përbejne 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Ortaku **z. Elis Sulaj** : Zoterues i 1 (nje) Kuote me vlerë të përgjithshme 50 Leke që përbejne 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

NENI 7

Organi Vendimmarres

Shoqeria eshte e organizuar ne organet e meposhteme:

- 1- Asambleja e Ortakeve Te Shoqerise
- 2- Bordi Drejtues
- 3- Administratori

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Ortakët mund të përfaqësohen në asamblenë e përgjithshme, nga një person i tretë me autorizimin perkates. Administrastoret e shoqerise nuk mund te veprojne si perfaqesues te ortakeve ne asamblene e pergjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

NENI 8

Administrimi

1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

3) Personat e mëposhtëm caktohen si Administrator te shoqërisë per nje afat 5 vjecar nga data e regjitrimit te kesaj shoqerie prane QKB-se dhe do te veprojne sebashku ose ne menyre te pavarur nga njeri-tjetri me tagra te pakufizuara secili.

- Silvi Shehi, atësia Luan, amësia Mimoza, shtetas Shqiptar, lindur në Tirane dhe banues në Tiranë, me adresë Zonja. Curre; Nd. 28/1; Njësia Administrative Nr. 2; Njesia Bashkiake Nr. 2; 0000; Tiranë, lindur më 01/06/1994, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Leternjoftim ID nr. 037229114 dhe nr. personal J40601071B, i cili në të njëjtën kohë ka edhe funksionin e perfaqesimit të shoqërisë me të tretet në gjithë veprimtarinë e shoqërisë në mënyrë të pavarur.
- Elis Sulaj, atësia Agim, amësia Flora, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Xhoxhi Martini; Nd. 28; H. 1; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1001; Tiranë, lindur më 31/08/1986, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Leternjoftim ID nr. 036449187 dhe nr. personal I60831064O, i cili në të njëjtën kohë ka edhe funksionin e perfaqesimit të shoqërisë me të tretet në gjithë veprimtarinë e shoqërisë në mënyrë të pavarur.

BORDI DREJTUES

NENI 9

- 1.** Bordin Drejtues është organi më i lartë drejtues dhe organizativ i shoqërisë.
- 2.** Ky Bord është krijuar për të ndihmuar, lehtësuar dhe drejtuar menaxhimin e aktivitetit të përditshëm të shoqërisë në të gjitha aspektet.
- 3.** Funksioni i Bordit Drejtues ka si qëllim mbarevajtjen, kontrollin e aktivitetit të përditshëm të shoqërisë si dhe të administratorit të saj.
- 4.** Anetar i Bordit Drejtues do të quhet çdo individ aktiv i cili zgjedhet dhe miratohet nga një procedurë e rregullt e deklaruar me pare nga perfaqesuesit e ortakeve të shoqërisë.
- 5.** Me procedurën e perzgjedhjes së aplikimit dhe pranimit për anetar në Bordin Drejtues ngarkohen perfaqesueset e ortakeve të shoqërisë, ku pranimi i çdo anetar duhet të marrë miratimin e 2/3 të ortakeve.
- 6.** Zgjedhja e anetareve të Bordit bëhet një herë në vit.
- 7.** Numri i përgjithshëm i anetareve të Bordit të ri Drejtues do të jetë deri në 5 veta.
- 8.** Çdo anetar ka për detyrë të marrë pjesë aktive në drejtimin dhe mbarevajtjen e aktiviteteve të përditshëm të shoqërisë.
- 9.** Çdo anetar ka të drejtë të mireinformohet për pozicionin që duhet të ketë në çdo situatë ku ai merr pjesë për përgjegjësinë të drejtë të një evenimenti të caktuar përfshirë kjo në funksionin e aktiviteteve të shoqërisë.
- 10.** E drejta e fjalës dhe degjimit i rezervohet çdo anetari përkundër vlerësimit të tij nga anetarët e tjerë të Bordit Drejtues.
- 11.** Çdo anetar ka të drejtë të hedhë në shqyrtim dhe diskutim çdo eveniment ekzistues të aktivitetit të përditshëm të shoqërisë.
- 12.** Imuniteti i Bordit Drejtues është një e drejtë që mund t'i percillet çdo anetari të Bordit kur ai ndodhet përballë një situatë që kërkon nderhyrjen ose bashkeveprimin e menjehershëm të Bordit Drejtues. Me rastin e pare ky aksion duhet të deklarohet për të marrë miratimin apo sygjerimet e ortakeve të shoqërisë.



13. Cdo anetar i bordit ka te drejten te komunikojë direkt me ortaket e shoqerise, per te kerkuar mendimin e tyre per nje ceshtje me interes per te gjithë.

14. Cdo anetar i bordit drejtues ka te drejten te monitorojë dhe te korrigojë qendrimet e administratorit/ve gjate aktivitetit te perditshem te punes kur keto qendrimet shkelin kompetencat e dhena administratorit/ve nga ky statut. Korrigjimi kryhet me terheqjen e vemendjes apo me sygjerimin per shkarkimin nga detyra e administratorit/ve te shoqerise, sygjerim ky qe percillet tek ortaket e shoqerise.

15. Anetaret e bordit, kane te drejten te negociojne me individe apo subjekte te ndryshme per ti sjelle shoqerise sherbime te reja ose per te financuar ato egzistuese.

16. Cdo anetar i Bordit duhet te jete pergjegjes per ruajtjen e personalitetin te tij, konfront cdo rrethane te krijuar.

17. Cdo anetar i Bordit Drejtues e ka per detyre te percoje ne shoqeri me menyren me te mire dhe jo te drejtperdrejte objektivat dhe qellimin e e politikave te shoqerise duke nderhyre me menyren me te mire.

18. Cdo anetar i bordit ka te drejte te nxjerre ne pah dhe terheqi vemendjen nje kolegu brenda bordit per sjellje te papergjegjshme ose jokohere me rregulloret e shoqerise. Sjelljet e papergjegjshme te perseritura jane subjekt marrje masash qe mund te cojne deri ne perjashtim nga bordi drejtues.

19. Votimi eshte procesi me kryesor i vendimarrjes se veprimeve nga ana e Bordit Drejtues. Eshte e detyrueshme pjesemarrja e cdo anetari duke dhene mendimin e tij: po, jo, abstenim

20. Cdo anetar ka te drejten hedhjes se nje ceshtjeje per votim si dhe te mbrojtjes dhe te analizimit te vendimit te tij.

21. Cdo anetar ka te drejten e nje vote.

22. Procedura e votimit percaktohet dhe drejtohet vetem nga ortaket e shoqerise me miratimin qe me pare te dy ose me shume anetareve te tjere te Bordit Drejtues.

23. Votimi merr vleren aktive vetem kur nga numerimi, rezulton se me shume se 2/3 e votave perkrahin ose hedhin poshte temen e dhene per shqyrtim.

24. Cdo votim nuk mund te zgjase me shume se tre dite. Ne qofte se pjesemarrja brenda afatit nuk kalon 2/3 e anetareve aktive te Bordit Drejtues, me miratim ose shtyhet edhe 2 dite te tjera afati.

NENI 10

Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- e) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese "Shoqeri ne likuidim e siper".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

NENI 11

Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

NENI 12

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.


NENI 13

Mosmarrëveshjet

Per mosmarrëveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarrëveshje qe mund te linde midis Shoqërisë dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptar. Ky akt themelimi është i përgatitur në 2 (dy) kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe me nga 6 (gjashtë) faqe secila.

ORTAKET E SHOQERISE

Z. SILVI SHEHI



Z. ELIS SULAJ

